



TË DHËNAT PËR ASETIN
Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.57
Njësia e Vendosur në Tender Nr.10
Parcelat nr.599-2 dhe 599-3 Z.K Kaliqan

Emri i NSh.-së	“KB “Vrella “, Istog (në likuidim)
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 10 Gusht 2022 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka parakualifikim
Depozita e Ofertës	5,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Fshati Kaliqan, Komuna e Istogut, Rajoni Pejë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Ndërtesat dhe tokat	<p>Kjo shitje përfshin tokën me sipërfaqe 5ha 34ari 77m² (53477 m²) që ndodhet në ZK Kaliqan, komuna Istog e cila përbëhet nga këto parcela kadastrale:</p> <p>00599-2 me sipërfaqe 12387m² kultura bujqësore, kullosë e klasës 3 dhe 00599-3 me sipërfaqe 41090m², kultura: pyjor, mal i klasës 2.</p> <p>-Parcelat kanë qasje në rrugën publike me nr.603.</p> <p>-Parcela nr.599-3 në pjesën jugore të saj përfshin në vete sipërfaqe të rrugës së asfaltuar me sipërfaqe të përafërt prej 131 m².</p> <p>-Pjesa jug-lindore e parcelës nr.599-3 është e rrethuar nga personat e panjohur dhe pa lejen e AL/AKP.</p>
Shfrytëzuesit	
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Asetet tjera	Nuk ekziston ndonjë marrëveshje mbi qira.
Detyrimet që do të barten	<p>Nuk ka.</p> <p>Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.</p>



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhena nuk janë të garantuara. Investitoret potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitoret potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacionet të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



Raporti i vizitës në
teren



RAPORT I VIZITËS NË TERREN

KB VRELLA, Parcelat nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan, Istog


Me datë 02.06.2022 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e KB Vrella, konkretisht parcelat me nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan, Komuna e Istogut.

Parcelat sipas certifikatës së pronësisë evidentohen në emër të KB Vrella.

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave është prej 53477m² (5 hektar, 34 ari dhe 77m²)prej të cilave :

Parcela nr. 599-2 ka sipërfaqe prej 12387 m² me kulturë: bujqësore, kullosë e klasës 3.

Parcela nr. 599-3 ka sipërfaqe prej 41090 m² me kulturë : pyjor, mal i klasës 2.



Ortofoto dhe kopjet e planit për parcelat nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan, Komuna e Istogut.

Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Është realizuar vërtetimi nga afër i parcelave nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan. Për shkak se parcela nr.599-3 është me kulturë pyjor-mal i klasës 2, atëherë e vetmja mënyrë e raportimit mbi gjendjen faktike të saj janë ortofotot dhe imazhet satelitore.

Raportimi është bërë nga analizat e bëra në ortofoto dhe kopje të planit.



- Parcelat nr.599-2 dhe 599-3 kanë qasje në rrugën publike me nr.603. Parcela nr.599-3 në pjesën jugore të saj përfshin në vete sipërfaqe të rrugës së asfaltuar me sipërfaqe të përafërt prej 131 m².
- Pjesa jug-lindore e parcelës nr.599-3 është e rrethuar.

Fotografitë e mëposhtme prezantojnë gjendjen faktike të parcelave nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan:



Pamje e parcelave nr.599-2 dhe 599-3 z.k Kaliqan,Istog

D.Gojani-Zyrtar Kadastral Rajonal
M.Ceman Morina- Zyrtare e Operacioneve për Administrim të Aseteve

AKP- ZR PEIË/Qershor 2022

Informatat

Dokumentet e Ofertimit

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext.1090, 2059
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës